

VENDIM
Nr.212, datë 25.7.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV ELRODI”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë ‘Albania Byaty’ sh.p.k. dhe propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të dokumentacionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “Tv Elrodi”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.7.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati